



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 507/1Prot.

Tiranë, më 07/04/ 2020

V E N D I M

Nr. 32 , Datë 07 / 04/ 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, mori në shqyrtim ankesën nr.1 Regj, datë 07.01.2020, që i përket ankuesit B.K, në të cilën ankuesi pretendon diskriminimin e djalit të tij O.K, për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Zyrës Vendore Arsimore Tiranë¹ dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë². Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi shpjegon se, në janar të 2019 si prindër kanë kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi mësues ndihmës për djalin e tyre, i cili është diagnostifikuar me çrregullim të spektrit autik dhe frekuenton Kopshtin nr. 18 në Tiranë. Pas një sorrollatje sa në DAR (sot ZVA), sa në QEZHFE, mbaroi viti shkollor dhe nuk u caktua mësues ndihmës. Djalit i’u mohua e drejta që i takonte duke ndikuar në këtë mënyrë në ecurinë e zhvillimit të tij.

Ankuesi shprehet se, sërish për vitin shkollor 2019-2020 kanë bërë kërkesë për mësues ndihmës. Janë thirrur në Komisionin Multidisiplinar në ZVA Tiranë, vetëm pasi kanë bërë ankesë në portalin e Bashkëqeverisjes. Aty i’u premtua se mësuesja ndihmëse do të vendosej, por nuk u specifikua sa orë dhe nuk u përcaktua as rutina gjatë javës. Mësuesja ndihmëse u paraqit duke ju përcjellë udhëzimin e marrë gojarisht se do të qëndronte vetëm ditën e premte për të mbështetur djalin. Një gjë e tillë për ankuesin është diskriminuese, pasi në konsultim me specialistë të fushës së zhvillimit të fëmijëve, kjo mbështetje nuk ka asnjë vlerë. Ndihmesa në procesin e nxënies duhet të jepet çdo ditë, si rutinë. Ankuesi ngre shqetësimin se, pse ndryshon masa e mbështetjes me mësues ndihmës për fëmijët me aftësi ndryshe në shkolla dhe pse në kopësht është vetëm 1 herë në javë. A nuk

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën ZVA Tiranë.

² Me vendimin Nr.159, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHFE) ka ndryshuar emërtimin në Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve (DPÇK). Në vijim do t’i referohemi me shkurtesat QEZHFE ose DPÇK DPÇK, në varësi të emërtimit zyrtar që ka patur ky institucion në momentin që kanë ndodhur ngjarjet.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

është ndërhyrja në moshën e hershme, më efikase? Gjithashtu ankuesi shprehet se, nuk ka marrë një dokument të shkruar ku të përcaktohet orari i mbështetjes me mësues ndihmës për djalë e tij dhe cilat janë arsyet pse Komisioni ka vendosur në këtë mënyrë.

Për sa më sipër dhe bazuar në ligjin nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit të djalit të tij O.K, vënien në dispozicion të vlerësimit të bërë nga komisioni multidisiplinar pranë ZVA Tiranë dhe ofrimin e mbështetjes me mësues ndihmës të shtrirë nga e hëna në të premte.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁴, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ankuesi B.K legjitimohet të paraqesë këtë ankesë duke pretenduar diskriminimin e djalit të tij, pasi në ushtrim të përgjegjësisë prindërore për djalë të tij O.K, është edhe përfaqësues i tij ligjor.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me aftësinë e kufizuar (neni 1⁵). Ligji Për mbrojtjen nga diskriminimi, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në mënyrë të posaçme LMD parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit në Kreun III. LMD në nenin 17/1/c/ç⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që bazohet në aftësinë e kufizuar, që i bëhet një nxënësi në gëzimin e të drejtës për arsim, duke përfshirë këtu si trajtimin dhe vlerësimin që i behet, por edhe përmbajtjen e parimeve dhe kriterëve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas neni 7 të LMD-së, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD..

⁵ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, **aftësinë e kufizuar**, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁶ Neni 17/1/c/ç, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohej çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) përmbajtjen e parimeve dhe kriterëve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies; ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr. 15/1 prot., datë 13.01.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion jo vetëm nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa por edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës.
- Me shkresën nr. 510 prot, datë 21.01.2020, Zyra Vendore Arsimore Tiranë, ka dërguar parashtrimet e saj në lidhje me ankesën.
- Me shkresën nr. 65/1 prot., datë 04.02.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë ka dërguar parashtrimet e saj në lidhje me ankesën.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si subjekt kundër të cilit është drejtuar ankesa nuk ka dërguar parashtrime në lidhje me ankesën.
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës gjithashtu nuk kanë kthyer asnjë përgjigje në lidhje me shkresën nr. 15/1 prot, datë 13.01.2020.
- Me shkresën nr. 15/3 dhe nr. 15/4 prot., datë 19.02.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion nga DPÇK, Bashkia Tiranë dhe ZVA Tiranë në lidhje me faktin nëse fëmija asistohet 5 orë mësimore në javë, sipas rekomandimit të komisionit multidisiplinar.
- Me shkresën nr. 65/3 prot., datë 25.02.2020, DPÇK, Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje duke deklaruar se nuk është në kompetencën e saj caktimi i mësuesit ndihmës.
- Në mungesë të informacionit në lidhje me faktin se sa orë mësimore në javë asistohet fëmija dhe si është shpërndarja e orëve mësimore gjatë javës, Komisioneri me shkresën nr. 357 prot., datë 28.02.2020, ka kërkuar informacion nga Kopshti nr.18, Tiranë. Kopshti nr.18 Tiranë nuk ka kthyer përgjigje për këtë shkresë.
- Me shkresën nr.1787 prot., datë 04.03.2020, ZVA Tiranë ka dërguar informacionin e kërkuar nga Komisioneri me shkresën nr. 15/4 prot., datë 19.02.2020. Bashkëlidhur kësaj shkrese është vendosur në dispozicion edhe një informacion i drejtueses së Kopshtit nr. 18, në lidhje me faktin se sa herë në javë dhe në çfarë orari, paraqitet mësuesi ndihmës në ambientet e Kopshtit Nr.18, për të asistuar fëmijën O.K. Informacioni nuk është shoqëruar me dokumentacion provues, si planeve të punës (ditor, javor ose mujor), shënimet ose vlerësimet përkatëse që mësuesi ndihmës harton për çdo orë mësimore që ka asistuar fëmijën, çdo dokument tjetër që tregon punën dhe vlerësimet e bëra nga mësuesi ndihmës për fëmijën.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në dokumentacionin e administruar rezulton se ankuesi B.K është babai i fëmijës O.K, i datëlindjes 27.02.2015. Ankuesi dhe familja e tij janë banorë në Njësinë Administrative Nr.2, në Bashkinë Tiranë. Rezulton se fëmija O.K është diagnostikuar me *çrregullim të spektrit të autizmit*. Sipas vërtetimeve të lëshuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë i Personave me Aftësi të Kufizuara Tiranë⁷, i ngritur pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë fëmija O.K është vlerësuar si fëmijë me aftësi të kufizuara, grupi i parë i cili ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi⁸. Aktualisht ai frekuenton Kopshtin Nr.18, në Tiranë. Sipas informacionit të grumbulluar rezulton se fëmija ka filluar frekuentimin pranë Kopshtit nr. 18, në Tiranë në vitin shkollor 2018-2019. Pretendimet e ankuesit konsistojnë në dy momente kryesore. *Së pari*, edhe pas kërkesave të shumta që kanë bërë si prindër së bashku me bashkëshorten, pranë institucioneve përgjegjëse, fëmijës nuk i'u mundësua asistencë me mësues ndihmës gjatë vitit shkollor 2018-2019 dhe *së dyti*, për vitin aktual mësimor 2019-2020 fëmijës nuk i ofrohet mbështetje me mësues ndihmës gjatë gjithë ditëve të javës, por fëmija asitohet nga një mësues ndihmës vetëm ditën e premte. Ata si prindër nuk kanë dijeni për orët mësimore që ka rekomanduar komisioni multidisiplinar për fëmijën e tyre, por shprehen se asistencë me mësues ndihmës nuk është efektive nëse nuk ofrohet përgjatë gjithë ditëve që fëmija frekuenton kopshtin. Për këtë arsye edhe analiza e mëposhtme do të realizohet duke vlerësuar në mënyrë të ndarë dy vitet shkollore.

- Mbështetja me mësues ndihmës gjatë vitit shkollor 2018-2019

Më datë 16.01.2019 znj. N.K, bashkëshortja e ankuesit dhe nëna e fëmijës O.K i është drejtuar QEZHEF me një ankesë mbi shkelje të vërejtura në Kopshtin 18, që frekuentohej nga djali i saj. Me një kërkesë që mban datën 17.01.2019, të dy prindërit e fëmijës i janë drejtuar QEZHEF duke i kërkuar ndër të tjera, caktimin e një mësuese ndihmëse, formimin e komisionit multidisiplinar të institucionit arsimor të zakonshëm (kopshtit), caktimin e një psikologu të përhershëm por edhe se përse nuk ishin informuar se djali i tyre i takonte një mësuese ndihmëse me ligj. Me shkresën nr. 66/1 prot., datë 28.01.2019, QEZHEF ka kthyer përgjigje për kërkesën e depozituar nga prindërit më datë 17.01.2019. Referuar përgjigjes, QEZHEF ka informuar prindërit se: *“Bazuar në ligjin 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, Kreu II, neni 20, “Shërbimi psiko-social” në institucionet parashkollore është kompetencë e njësive arsimore vendore. DAR Tiranë⁹ më datë 04.12.2018 ka përcjellë zyrtarisht pranë QEZHEF informacionin se, komisioni multidisiplinar është në procesin e shqyrtimit të të gjitha rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë institucionet arsimore parashkollore në Bashkinë Tiranë. Pas përfundimit të këtij procesi, DAR Tiranë do të paraqesë pranë QEZHEF numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. QEZHEF me disponimin e këtij informacioni, do të përlllogarisë sipas nevojave për secilin kopsht, numrin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Krahas mësuesve ndihmës, Bashkia e Tiranës ka miratuar shtimin e numrit të edukatoreve dhe punëtorëve në kopshte, duke iu referuar nevojave*

⁷ KMCAPI i PAK, Tiranë.

⁸ Vendim nr. 4044 datë 16.10.2018 dhe Vendim nr. 5401 datë 05.11.2019 i KMCAPI për vlerësimin e PAK, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.

⁹ Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, aktualisht Zyra Vendore Arsimore Tiranë (ZVA Tiranë)

të paraqitura. Monitorimi dhe zbatimi i aktivitetit ditor dhe planeve edukative është kompetencë e drejtoreshave të kopshteve.”

Në vijim ankuesi i është drejtuar përsëri QEZHEF me një ankesë që mban datën 31.01.2019, për shkelje të legjislacionit në fuqi nga drejtoresha e Kopshtit nr. 18, Tiranë. Sipas ankuesit drejtuesja e kopshtit nuk ka formuar komisionin multidisiplinar për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ka penguar hartimin e Planit Edukativ Individual (PEI) për fëmijën, si dhe problematika të tjera në drejtim të vlerësimit të fëmijës, vendosjes së tij në një grup që sipas tij nuk përkon me moshën e fëmijës si dhe aspekte të tjera që i takojnë kurrikulës që zbatohet në kopsht dhe kohëzgjatjes së programit arsimor.

Me shkresën nr. 66/3 prot, datë 14.02.2019, rezulton se QEZHEF i ka kthyer përgjigje ankesës së datës 31.01.2019. Referuar kësaj përgjigje rezulton se sipas procesverbalit të datës 22.10.2018, drejtuesja e Kopshtit nr.18 ka ngritur komisionin për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe në mungesë të psikologes, e cila mungon që prej muajit prill 2018, komisioni ka në përbërje drejtuesen e kopshtit dhe mësueset e grupeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë kopshtin. Në të njëjtën ditë, pra më datë 22.10.2018 rezulton të jetë hartuar PEI për fëmijën O.K, por ky dokument nuk rezulton të jetë hartuar në bashkëpunim me prindërit pasi nuk është nënshkruar prej tyre.

Referuar shkresës nr.510 prot datë 21.01.2020 të ZVA Tiranë rezulton se për vitin shkollor 2018-2019, drejtorja e Kopshtit nr. 18, Tiranë ka paraqitur kërkesë për vlerësimin e fëmijës O.K më datë 07.01.2019. Pas shqyrtimit të kërkesës për vlerësim, Komisioni ka kryer procedurat e vlerësimit të fëmijës më datë 10.01.2019 në mjediset e Kopshtit nr.18. Në përfundim të vlerësimit komisioni ka dalë me rekomandimin që mban datën 04.02.2019, nr.extra prot, që fëmija të asistohet nga mësues ndihmës çdo ditë në kohën e mësimdhënies Ky rekomandim i komisionit multidisiplinar pranë DAR Tiranë, i është përcjellë për zbatim QEZHEF me shkresën nr.1154 prot., datë 06.03.2019.

Me një kërkesë që mban datën 04.02.2019, nëna e fëmijës znj. N.K i është drejtuar DAR Tiranë për caktimin e një psikologu në Kopshtin nr.18, pasi deri në këtë datë pranë këtij kopshti nuk ka psikolog të emëruar. Me shkresën nr.419/1 prot datë 12.02.2019, DAR Tiranë ka kthyer përgjigje për ankesën e datës 04.02.2019 duke informuar se në zbatim të parashikimeve të bëra në gërmën “a” të pikës 5, të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.344, datë 19.08.2013 *“Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”*, në Kopshtin nr.18 Tiranë ofrohet shërbim psikologjik nga ana e psikologes E.M e cila është prezent gjatë gjithë javës. Sipas një informacioni të dërguar me shkresën nr.41 prot datë 11.02.2019 nga ana e drejtueses së Kopshtit nr. 18, kjo e fundit informon DAR Tiranë se: *“Në kopshtin 18 për periudhën janar-shkurt 2019 QEZHEF ka sjellë në ndihmë të fëmijës me aftësi të kufizuara O.K psikologun E. M”*.

Në vijim të shkresës nr.419/1 prot datë 12.02.2019 të DAR Tiranë, prindërit e fëmijës i janë drejtuar përsëri kësaj të fundit me një kërkesë që mban datën 01.03.2019, duke shprehur shqetësimin në lidhje me mungesën e psikologut dhe duke kërkuar të emërohet një psikolog me vendim zyrtar në kopshtin nr.18 sipas legjislacionit në fuqi. Në përgjigje të kërkesës së prindërve të datës 01.03.2019, me shkresën nr.1074/1 prot datë 07.03.2019, DAR Tiranë ka informuar se, komisioni multidisiplinar i ngritur pranë DAR Tiranë ka rekomanduar për fëmijën O.K asistimin e

tij me mësues ndihmës. Ky rekomandim i është përcjellë për zbatim QEZHEF, e cila do të bëjë caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijën O.K pranë Kopshtit nr. 18 Tiranë. Në lidhje me caktimin e një psikologu pranë kopshtit që frekuentohet nga fëmija, DAR Tiranë shprehet se në vazhdimësi në kopshtin nr.18 Tiranë do të ofrohet shërbim psikologjik nga ana e psikologes së përcaktuar nga ky institucion sipas normativës së përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 344, datë 19.08.2013 *“Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”*.

Deri më datën 04.02.2019, komisioni multidisilinar nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim për nevojat e fëmijës pas vlerësimit që kishte realizuar më datë 10.01.2019. Rekomandimi i komisionit multidisiplinar për të asistuar fëmijën me mësues ndihmës është marrë më datë 04.02.2019 dhe i është njoftuar QEZHEF më datë 16.03.2019. Edhe pas datës 16.03.2019 nuk rezulton që fëmija të jetë asistuar nga mësuesi ndihmës. Sa më sipër rezulton se për gjatë gjithë vitit shkollor 2018-2019 fëmija O.K nuk është asistuar nga mësues ndihmës.

- Mbështetja me mësues ndihmës gjatë vitit shkollor 2019-2020.

Me një kërkesë që mban datën 17.09.2019, prindërit e fëmijës i janë drejtuar ZVA Tiranë për caktimin e një mësueseje ndihmëse për djalë të tyre. Rezulton se për vlerësimin e fëmijës O.K me një kërkesë që mban datën 18.10.2019, ZVA Tiranë i është drejtuar edhe drejtuesja e kopshtit nr. 18, Tiranë. Sipas shkresës nr. 510 prot datë 21.01.2020 të ZVA Tiranë, në datë 24.10.2019 ka filluar faza e vlerësimit të fëmijëve të kopshteve sipas kërkesave të ardhur nga drejtoritë përkatëse dhe prindërit. Fëmija O.K rezulton të jetë vlerësuar më datë 24.10.2019 në mjediset e ZVA Tiranë. Pas vlerësimit komisioni ka dalë me rekomandimin nr.extra prot., datë 25.10.2019 duke rekomanduar që fëmija të asistohet me mësues ndihmës 5 orë mësimore në javë, duke e shpërndarë këtë ngarkesë mësimore me 1 orë mësimore në ditë. Procesi i vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara rezulton të ketë përfunduar më datë 17.12.2019. Përmbledhja e rekomandimeve me orët përkatëse për të gjithë fëmijët e vlerësuar në kopshte i është përcjellë QEZHEF për zbatim me shkresën nr. 65/1 prot., datë 01.01.2020.

Referuar shkresës nr. 510 prot., datë 21.01.2020 ZVA Tiranë shprehet se: *“Për të mbuluar nevojat arsimore të fëmijës O.K deri në përfundim të procedurave të vlerësimit, nga Komisioni Multidisiplinar ZVA Tiranë dhe caktimit të mësuesve ndihmës në institucionet e arsimit parashkollor nga QEZHEF, duke i'u referuar Portalit “Mësues për Shqipërinë”, ZVA Tiranë ka caktuar një mësues ndihmës për fëmijën O.K deri në vendosjen e mësuesit ndihmës nga QEZHEF”*. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ZVA Tiranë rezulton se është hartuar PEI për fëmijën O.K më datë 15.11.2019, i cili është nënshkruar edhe nga nëna e fëmijës.

Ankuesi pretendon se fëmija asistohet nga një mësues ndihmës vetëm një herë në javë dhe konkretisht ditën e premte. Procesi i vlerësimit të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet në qytetin e Tiranës rezulton se ka përfunduar më datë 17.12.2019 dhe rezultatet i janë përcjellë për zbatim QEZHEF me datë 07.01.2020, por ndërkohë rekomandimi i komisionit multidisiplinar për fëmijën O.K ka dalë më datë 25.10.2019. Referuar përgjigjes së dërguar nga ZVA Tiranë me shkresën nr. 510 prot datë 21.01.2020 nuk del qartë fakti nëse mësuesi që ZVA Tiranë ka vendosur në dispozicion për fëmijën e asiston atë sipas rekomandimit të komisionit multidisiplinar. Për të qartësuar këtë moment dhe pretendimin e ankuesit se mësuesi ndihmës asiston fëmijën vetëm ditën

e premtë Komisioneri ka kërkuar informacion shtesë nga ZVA Tiranë dhe DPÇK, Bashkia Tiranë. Bazuar në shkresën nr.1787 prot., datë 04.03.2020 të dërguar nga ZVA Tiranë, rezulton se mësuesja ndihmëse e vendosur nga ZVA Tiranë ofron asistencën e saj për fëmijën O.K çdo ditë të premtë nga ora 8.00 deri në orën 14.00.

Për vitin shkollor 2019-2020, rezulton se deri më datën 25.10.2019, komisioni multidisiplinar nuk kishte nxjerrë asnjë rekomandim për nevojat e fëmijës. Rekomandimi i komisionit multidisiplinar për të asistuar fëmijën me mësues ndihmës i është njoftuar QEZHEF (sot DPÇK) më datë 07.01.2020. Edhe pas datës 07.01.2020 DPÇK, Bashkia Tiranë nuk rezulton që të ketë marrë asnjë masë për të zbatuar rekomandimin e komisionit multidisiplinar dhe për të siguruar mësuesin ndihmës. Për më tepër DPÇK jo vetëm që nuk parashtroi asnjë justifikim për mosmarrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të komisionit, por shprehet se caktimi i mësuesit ndihmës nuk është kompetencë e saj por e institucioneve vendore arsimore (DRAP dhe ZVAP). Gjithashtu asistimi i fëmijës me mësues ndihmës vetëm një ditë në javë, duke realizuar orët mësimore të rekomanduara nga komisioni multidisiplinar në një ditë të vetme, pra çdo ditë të premtë nga ora 08.00 deri më 14.00, nuk është në përputhje me rekomandimin e komisionit multidisiplinar i cili ka rekomanduar që fëmija duhet të asistohet me mësues ndihmës 5 orë mësimore në javë, duke e shpërndarë këtë ngarkesë mësimore çdo ditë të javës me 1 orë mësimore në ditë.

- **Kuadri ligjor që rregullon arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor parauniversitar.**

E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Bazuar në Kushtetutë, kushdo ka të drejtën për arsimim. Bazuar në nenin 2, të ligjit Nr.69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*¹⁰, arsimi parashkollor është pjesë e arsimit parauniversitar. Për këtë arsye kopshtet si pjesë e arsimit parashkollor janë institucione arsimore që funksionojnë në kuadër të sistemit arsimor parauniversitar. Ligji Nr.69/2012 *“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsim, në nenet 63-65, rregullon shprehimisht arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ligji garanton në nenin 64/3 dhe 65/3, të drejtën e nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët ndjekin arsimin parauniversitar për të patur mësues ndihmës, bazuar në rekomandimin e komisionit multidisiplinar që bën vlerësimin e nevojave të fëmijëve.

Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar¹¹, të cilat kanë qenë në fuqi deri më datë 28.01.2020, në nenet 93-101, parashikojnë rregulla të detajuara në lidhje me arsimimin e

¹⁰ Neni 2, pika1, gërma “a”, ligji nr. 69/2012, I ndryshuar : *“1. "Arsimi parauniversitar" përfshin nivelet arsimore me kodet 0, 1, 2 dhe 3, sipas "Klasifikimit Ndërkombëtar Standard të Arsimit", të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në sesionin e 29-të të saj, në nëntor 1997, përkatësisht: a) "Niveli me kodin 0", arsimi parashkollor;.....”*

¹¹ Miratuar me urdhrin nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, ndryshuar me urdhrin nr. 37, datë 29.01.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Dispozitat Normative për Sistemin arsimor Parauniversitar, të miratuara me këtë urdhrë janë shfuqizuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me anë të të cilit është miratuar Rregullorja për Funksionimin e Institucioneve Arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, e cila ka zëvendësuar Dispozitat Normative.

fëmijëve me aftësi të kufizuara. Arsimi parashkollor si pjesë e arsimit parauniversitar, është rregulluar në Kreun II të Dispozitave Normative, konkretisht në nenet 5 dhe 6, ku është përcaktuar organizimi i kopshteve, ndjekja e arsimit parashkollor, procedurat e regjistrimit në kopshtin publik si dhe kurrikula e kopshtit.

Ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, garanton të drejtën për mësues ndihmës të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar se kanë nevojë për mbështetje nëpërmjet një mësuesi ndihmës, në mënyrë që të realizohet në mënyrë efektive e drejta e tyre për arsim. Mbështetja nëpërmjet një mësuesi ndihmës është një ndër format, por jo forma e vetme e mbështetjes që duhet të ofrohet në mënyrë që të garantohet pa diskriminim e drejta për arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Neni 65 i ligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se nxënësit me aftësi të kufizuara duhet të mësojnë sipas një plani mësimor që në çdo rast duhet të jetë i përshtatur me nevojat e fëmijës, duke vendosur kështu detyrimin për hartimin e planeve mësimore-edukative të personalizuar për çdo nxënës me aftësi të kufizuara.

Bazuar në nenin 93, të Dispozitave Normative, parashikohet se Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar i cili realizon vlerësimin e nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara, ndër të tjera, jep rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas; sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin si dhe rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese. Referuar nenit 93, pika 2 të Dispozitave Normative, komisioni multidisiplinar i ngritur vlerëson nevojat e fëmijës me aftësi të kufizuara me kërkesën e prindit ose të drejtorit të institucionit arsimor.

Sipas dokumentacionit dhe informacionit të grumbulluar, rezulton se për vlerësimin e fëmijës O.K ka paraqitur kërkesë drejtuesja e kopshtit nr.18 Tiranë më datë 07.01.2019. Rezulton sipas kërkesës së datës 17.01.2019 që prindërit e fëmijës i kanë drejtuar QEZHEF (protokolluar në QEZHEF me nr. 66 prot datë 18.01.2019) se ata kërkojnë vlerësimin e fëmijës së tyre dhe caktimin e një mësuesi ndihmës dhe se nuk kanë patur dijeni që fëmija e tyre përfiton mësues ndihmës sipas ligjit. Vlerësimi i fëmijës është realizuar më datë 10.01.2019 nga komisioni multidisiplinar i ngritur pranë DAR Tiranë i cili ka rekomanduar që fëmija të asistohet me mësues ndihmës çdo ditë në kohën e mësimdhënies dhe se ky rekomandim i është përcjellë për zbatim QEZHEF me shkresën nr.1074/ 1 prot datë 07.03.2019.

Bazuar në nenin 93, pika 3 e Dispozitave Normative, komisioni multisiplinar mbledhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor. Referuar kësaj dispozite komisioni multidisiplinar duhet të ishte mbledhur përpara fillimit të vitit shkollor 2018-2019. Rezultoi se komisionit multidisiplinar pranë DAR Tiranë (sot ZVA Tiranë) nuk është mbledhur në respektim të afateve të përcaktuara nga neni 93 pika 3 të DN, pasi ai ka bërë vlerësimin e fëmijës më datë 10.01.2019, rekomandimi është lëshuar më datë 04.02.2019 ndërsa zyrtarisht ky rekomandim i është përcjellë QEZHEF më datë 06.03.2019.

Gjithashtu rezulton se fëmija O.K nuk është asistuar me mësues ndihmës edhe pasi DAR Tiranë ka përcjellë zyrtarisht për zbatim rekomandimet e komisionit multidisiplinar pranë QEZHEF me shkresën nr.1074/1 prot datë 07.03.2019. Me shkresën nr.66/1 prot datë 28.01.2019, në përgjigje të kërkesës së bërë nga prindërit e fëmijës më datë 17.01.2019 pranë QEZHEF, kjo e fundit shprehet se pasi të marrë informacionin nga DAR Tiranë në lidhje me numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara do të përllogarisë sipas nevojave për secilin kopsht numrin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. QEZHEF e ka marrë këtë informacion nga DAR Tiranë më datën 06.03.2019, por nuk rezulton të ketë marrë asnjë veprim për të asistuar fëmijën O.K me mësues ndihmës në përputhje me rekomandimin e komisionit multidisiplinar.

Bazuar në nenin 93, pika 3 e Dispozitave Normative, të cilat kanë qenë në fuqi deri më datën 28.01.2020, edhe për vitin shkollor 2019-2020, Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë ZVA Tiranë (ish DAR Tiranë) i cili duhet të kishte bërë vlerësimin e vëmijëve që ndjekin arsimin parauniversitar, përfshi këtu edhe arsimin parashkollor si pjesë përbërëse të tij, përpara fillimit të vitit shkollor 2019-2020, e ka përfunduar vlerësimin më datë 17.12.2019 dhe i ka përcjellë rekomandimet për zbatim pranë QEZHEF (aktualisht DPÇK, Bashkia Tiranë) më datë 07.01.2020. Nëse për vitin shkollor 2018-2019, QEZHEF është shprehur se do të përllogarisë nevojat për mësues ndihmës sapo të disponojë informacionin nga komisioni multidisiplinar i ngritur pranë DAR Tiranë, për vitit shkollor 2019-2020 nëpërmjet përgjigjes që i ka vënë në dispozicion Komisionerit shprehet se nuk është kompetencë e saj caktimi i mësuesit ndihmës për fëmijët që ndjekin arsimin parashkollor publik.

Neni 93, pika 3 e Dispozitave Normative, duke parashikuar që komisioni multidisiplinar duhet të mbledhet para fillimit të vitit shkollor, në fund të simestrit të parë dhe në përfundim të shkollës, synon të garantojë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar që në momentin e fillimit të vitit shkollor si dhe të mbulojë çdo ndryshim që mund të ndodh me nevojat e fëmijëve gjatë vitit shkollor duke parashikuar mbledhje në fund të simestrit të parë dhe në përfundim të shkollës për të vlerësuar në mënyrë efektive arritjet e fëmijëve dhe efektivitetin e mbështetjes së ofruar me mësues ndihmës dhe hartimin e Planeve Edukative Individuale (PEI)

Rregullorja për Funksonimin e Institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, e cila është miratuar me urdhrin nr.31, datë 28.01.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ka hyrë në fuqi menjëherë (pra më datë 28.01.2020), gjithashtu parashikon rregulla të detajuara në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar. Ky rregullim bëhet në Kreun XIV, nga neni 80 deri në nenin 87. Rregullorja për Funksonimin e Institucioneve arsimore parauniversitare në të njëjtën mënyrë si Dispozitat Normative ka përcaktuar në nenet 5 dhe 6, të saj rregulla për mënyrën e organizimit të institucioneve të arsimit parashkollor si dhe kurrikulat përkatëse. Kjo rregullore ka përcaktuar të njëjtën mënyrë të mbledhjes së komisionit multidisiplinar të ngritur pranë ZVA, në nenin 80 pika 4 të saj.

Sa më sipër rezulton se fëmijës O.K , i cili është një fëmijë me aftësi të kufizuara i është mohuar e drejta për të patur mbështetje nëpërmjet një mësuesi ndihmës sipas vlerësimit të bërë nga komisioni multidisiplinar, në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi si më sipër janë përmendur. Mungesa e mësuesit ndihmës e vendos fëmijën O.K, në kushte më pak të favorshme për të siguruar me të njëjtën cilësi dhe mbi baza të barabarta me fëmijët e tjerë

të drejtën për t'u arsimuar, duke e ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, referuar parashikimit të bërë në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

B. Shkak i mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹², i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë edhe shkakun e aftësisë së kufizuar. Megjithatë jo shprehimisht e përfshirë në listën e shkaqeve të mbrojtura të KEDNJ-së, aftësia e kufizuar është përfshirë nga KEDNJ-ja në interpretimin e shkaqeve “të tjera” sipas nenit 14. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK), e ratifikuar nga vendi ynë ndalon çdo formë diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkak të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar diskriminim e djalit të tij në gëzimin mbi baza të barabarta të të drejtës për arsim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”. Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ky shkak i pretenduar nga ankuesi konsiderohet si shkak i mbrojtur. Bazuar në dokumentacionin e administruar, rezulton se fëmija O.K, i cili është diagnostikuar me *çrregullim të spektrit të autizmit* sipas vërtetimit të lëshuar nga KMCAP i PAK Tiranë është vlerësuar si fëmijë me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, në bazë të vlerësimeve të bëra nga komisioni multidisiplinar i ngritur pranë DAR Tiranë për vitin arsimor 2018-2019 dhe komisionit multidisiplinar të ngritur pranë ZVA Tiranë për vitin shkollor 2019-2020 fëmija O.K është vlerësuar si fëmijë me aftësi të kufizuara i cili ka nevojë për mbështetje me mësues ndihmës.

Për këto arsye, Komisioneri vlerëson se ankuesi ka të vërtetuar shkakun e aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit “Kushdo ka të drejtën për arsimim”. Protokoli Nr.1, Neni 2 i KEDNJ përmban një të drejtë të pavarur për arsimim. Neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të dhe për këtë arsye GJEDNJ-në i trajton ankimimet për diskriminim në fushën e arsimit të përfshira brenda sferës së Nenit 14. Ndërkohë Protokoli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje

¹² Shih më lart *footnote* nr. 3.

me “gëzimin e çdo të drejte të parashikuar nga ligji”. Fëmija i ankuesit ndjek arsimin parashkollor, i cili është pjesë e arsimit parauniversitar dhe për këtë arsye në rastin konkret gjen zbatim kuadri ligjor dhe nënligjor që rregullon sistemin arsimor parauniversitar.

Ligji “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin. E në fakt mosdiskriminimi dhe parimi i barazisë janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme.¹³ Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji. Përveç këtij parashikimi të përgjithshëm për fushën e veprimit të Ligjit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi të gjitha të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligjet në fuqi, ky ligj trajton në mënyrë të veçantë mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e arsimit, pra të drejtën për arsim. Bazuar në nenin 17/1/c, Ligji Për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që bazohet në aftësinë e kufizuar, që i bëhet një individit në gëzimin e të drejtës për arsim, duke përfshirë këtu si trajtimin dhe vlerësimin që i behet, por edhe përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies.

Bazuar në nenin 7, të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, diskriminimi konsumohet si me veprim ashtu edhe me mosveprim nga ana e autoriteteve publike ashtu edhe subjekteve private, që e ekspozojnë personin apo grupin e personave ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona ose grupe personash të tjerë. Në bazë të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”. Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

¹³ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

Sipas nenit 2, të KDPAK, “Diskriminim me bazë aftësinë e kufizuar” do të thotë që çdo dallim, përjashtim apo kufizim me bazë aftësinë e kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në dëmtimin apo anulimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, mbi baza të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Sipas nenit 5, pika 2, të KDPAK ndalohet çdo lloj apo formë diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar.

Rezultoi e provuar se fëmijës së mitur të ankuesit, i cili ndjek arsimin parashkollor në institucionin arsimor publik Kopshtin nr.18, në qytetin e Tiranës, nuk i është siguruar mbështetja me mësues ndihmës, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në këtë mënyrë, Komisioneri si më sipër është arsyetuar, konstatoi se fëmija O.K, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë e më pak të favorshëm duke cënuar të drejtën e tij për arsim.

E drejta për arsim nuk është një privilegj. Ajo është një e drejtë e njeriut. Si e drejtë njerëzore, e drejta për arsim do të thotë që të gjithë- fëmijë, adoleshentë, të rinj, të rritur, dhe të moshuarit - kanë të drejtë të kenë akses në një arsim cilësor. Kjo do të thotë se shteti ka detyrime të ndryshme për ta bërë të drejtën për arsimim një realitet për të gjithë. Mosveprimi nuk është një mundësi¹⁴.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 57 të kushtetutës, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. Rëndësia e të drejtës për edukim mbështetet në atë që, ushtrimi i shumë të drejtave të tjera, varet në radhë të parë nga realizimi i të drejtës për arsim, siç theksohet në Komentin e Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim. E drejta për arsim garantohet në kuadër të shumë marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor jo vetëm të detyrueshme për t’u zbatuar por bazuar në nenin 116 të Kushtetutës në hierarkinë e normave juridike ato renditen menjëherë pas Kushtetutës, të tilla si: Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Social dhe Kulturore, garanton të drejtës për arsim në nenet 13 e 14; Protokolli shtesë i Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, në nenin 2, sanksionon se askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsim dhe Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (KDPAK).

KDPAK përbën standartin më të lartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Kjo Konventë në nenin 24 të saj, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim. Sipas nenit 24, të KDPAK, e drejta për arsim e personave me aftësi të kufizuara realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, nëse garantohet një sistem edukimi gjithëpërfshirës. Sipas pikës 2, të nenit 24 të KDPAK, për të realizuar këtë të drejtë, shteti duhet të sigurojë se:

- personat me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga sistemi i edukimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga arsimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimi i mesëm, me bazë aftësinë e kufizuar;

¹⁴ Right to education handbook, publikim i UNESCO dhe The Global Education 2030 Agenda, faqe 23

- personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë për edukimin fillor përfshirës, cilësor dhe pa pagesë dhe arsimin tetëvjeçar në baza të barabarta me të tjerët në komunitetet ku ata jetojnë;
- sigurohet akomodimi i arsyeshëm i kërkesave individuale;
- personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetjen e kërkuar brenda sistemit të edukimit të përgjithshëm, për të mundësuar arsimimin e tyre efektiv;
- *sigurohen masa mbështetëse efektive të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në pajtim me qëllimin për përfshirje të plotë.*

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta. (neni 28 i Konventës) Ligji i posaçëm që mbron të drejtat e fëmijës, konkretisht ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, sanksionon se realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke u bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim.

Legjislacioni në fuqi në përputhje me standartet ndërkombëtare parashikon që e drejta për arsim garantohet pa diskriminim për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga aftësia e kufizuar. Por garantimi i të drejtës për arsim nuk nënkupton vetëm pranimin në institucionet arsimore dhe prezencën fizike të fëmijëve në këto ambiente, por që fëmijët të marrin një arsim gjithëpërfshirës cilësor dhe të barabartë. Gjithpërfshirja nuk duhet ngatërruar me integrimin. Integrimi¹⁵ është procesi i vendosjes së nxënësve të etiketuar se kanë “nevoja speciale” arsimore, në arsimin e zakonshëm, me disa përshtatje dhe burime, por me kushtin që ata të mund të përshtaten me strukturat ekzistuese, sjelljet dhe një mjedis të pandryshuar.

Arsimi gjithëpërfshirës¹⁶ bazohet në parimin se të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, pavarësisht ndryshimeve. Arsimi gjithëpërfshirës njeh aftësinë e çdo personi për të mësuar dhe pranon që secili person ka pika të forta, kërkesa dhe stile të mësuarit të ndryshme. Gjithpërfshirja, pra, merr një qasje të individualizuar në programet mësimore, mësimdhënie dhe metodat e mësimnxënies që janë fleksibël dhe të lehtësisht të përshtatshme. Duke marrë parasysh dallimet midis nxënësve, arsimi gjithëpërfshirës promovon respektin, vlerën e diversitetit dhe kërkon të luftojë sjelljet diskriminuese si në klasë ashtu edhe në shoqëri. Arsimi gjithëpërfshirës adreson pengesat specifike me të cilat njerëzit përballen në gëzimin e së drejtës së tyre për arsim, përmes mbështetjes dhe përshtatjes, siguron aksesin efektiv në arsim dhe realizimin e potencialit të tyre individual në baza të barabarta me nxënësit e tjerë brenda një ambianti mësimor ku të gjithë janë pjesëmarrës.

Gjithëpërfshirja nuk përbëhet dhe nuk konsiderohet e përmbushur vetëm nga një element si psh. hartimi i PEI. Gjithëpërfshirja kërkon ndërmarrjen e një tërësi veprimesh dhe qasje shumëdimensionale, në mënyrë që të realizohet, duke përfshirë këtu edhe ofrimin e mbështetjes me mësues ndihmës, një e drejtë kjo që garantohet nga legjislacioni në fuqi.

¹⁵ Right to education handbook, publikim i UNESCO dhe The Global Education 2030 Agenda, faqe 91

¹⁶ Right to education handbook, publikim i UNESCO dhe The Global Education 2030 Agenda, faqe 87

Sipas Komentit të Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim, arsimi në të gjitha format e tij dhe në të gjitha nivelet duhet të ketë karakteristikat si vijon, të cilat janë thelbësore dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën: disponueshmëria, mundësia e përdorimit/aksesueshmëria, pranueshmëria, përshtatshmëria. Sipas Komentit të përgjithshëm nr.4 (2016) mbi të drejtën për arsim gjithëpërfshirës, të Komitetit të OKB-së Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, për të vlerësuar garantimin e të drejtës për arsim gjithëpërfshirës, duhet të merren në konsideratë të katërt këta elementë apo karakteristika. Nën karakteristikën e përshtatshmërisë që duhet të ketë arsimi gjithëpërfshirës, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 4, paragrafin 32, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara sqaron se:

Që neni 24 (2) (e)¹⁷ të realizohet, duhet të ofrohet menjëherë mbështetje e përshtatshme, e vazhdueshme dhe e personalizuar. Komiteti thekson nevojën për të siguruar plane arsimore të individualizuara që mund të identifikojnë përshtatje të arsyeshme dhe mbështetje specifike të kërkuar nga nxënës të veçantë..... Mbështetja gjithashtu mund të përbëhet nga një asistent i kualifikuar i cili ndihmon në mësim, qoftë mbi baza të përbashkëta ose në baza një-për-një, në varësi të kërkesave të nxënësit..... Efektiviteti i planeve të tilla duhet të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht me përfshirjen e drejtpërdrejtë të nxënësit. Natyra e këtyre masave duhet të përcaktohet në bashkëpunim me nxënësin, së bashku, kur është e përshtatshme, me prindërit, kujdestarët ose palët e tjera të treta.

Legjislacioni në fuqi në përputhje me parashikimet e KDPAK, garanton të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës duke parashikuar se fëmijët në arsimin parauniversitar kanë të drejtën për mbështetje nëpërmjet mësuesit ndihmës. Hartimi i PEI, zbatimi dhe monitorimi i tij është një detyrim ligjor i ndryshëm nga asitenca me mësues ndihmës, por të dy së bashku plotësojnë njëri tjetrin në drejtim të qëllimit final që është gatimi i të drejtës për arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për më tepër, në rast se nuk sigurohet mbështetja me mësues ndihmës në ato raste që janë vlerësuar nga komisioni multidisiplinar se kanë nevojë për asistencë me mësues ndihmës dhe sipas mënyrës së përcaktuar nga komisioni, zbatimi i PEI në mënyrë efektive dhe cilësore çënohet. Kjo do të thotë se nëse komisioni multidisiplinar ka vlerësuar nevojën që fëmija të ketë një mësues ndihmës i cili do të sigurojë zbatimin efektiv dhe cilësor të PEI, pretendimi se PEI zbatohet dhe monitorohet me përpikmëri në mungesë të asistencës me mësues ndihmës, është i pabazuar.

Detyrimi për të siguruar mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk duhet të kalojë mbi familjen pasi është një detyrim ligjor i institucioneve përgjegjëse pa mohuar këtu detyrimin për të bashkëpunuar me prindërit apo familjen e fëmijës.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, në pikën 12, të tij shprehet se: “Barazia dhe mosdiskriminimi janë parime dhe të drejta. Konventa u referohet atyre në nenin 3 si parime dhe në nenin 5 si të drejta. Ato janë gjithashtu një mjet interpretues për të gjitha parimet dhe të drejtat e tjera të mishëruara në

¹⁷ Neni 24 (2) (e) KDPAK parashikon: “2. Për të realizuar këtë të drejtë (arsim), shtetet palë duhet të sigurojnë se: e) sigurohen masa mbështetëse efektive të individualizuara në ambiente që rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror, në pajtim me qëllimin për përfshirje të plotë.”

Konventë. Parimet/e drejta për barazi dhe mosdiskriminim janë gur themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të garantuar nga Konventa. Promovimi i barazisë dhe trajtimi i diskriminimit janë detyrime ndërsektoriale të realizimit të menjëhershëm. Ato nuk i nënshtrohen realizimit progresiv.”

Konventa e UNESCO Kundër Diskriminimit në Arsim, në nenin 1, pika 1, gërma “b”, parashikon se: *“Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "Diskriminimi" përfshin çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë për të cilën, duke u bazuar në raca, ngjyra, seks, gjuha, bindjet fetare, politike apo të tjera, origjina kombëtare ose shoqërore, gjendja ekonomike ose lindja, ka si qëllim ose efekt e mohimit ose pengimit të barazisë në trajtim në arsim dhe në veçanti: ”b” **duke kufizuar çdo person ose grup personash në një edukim të një standardi inferior**”*

Ndalimi i diskriminimit nuk i nënshtrohet as realizimit progresiv, as disponueshmërisë së burimeve; ai zbatohet plotësisht dhe menjëherë për të gjitha aspektet e arsimit dhe përfshin të gjitha shkaqet e mbrojtura të diskriminimit. Arsimi duhet të monitorohet nga afër - përfshirë të gjitha politikat, institucionet, programet, modelet e shpenzimeve dhe praktikatat e tjera - në mënyrë që të identifikohen dhe të merren masa për të korrigjuar çdo diskriminim de-fakto¹⁸.

Dështimi për t’u garantuar fëmijëve me aftësi të kufizuara akses të barabartë në institucionet arsimore të zakonshme me arsim gjithpërfshirës dhe cilësor, përbën diskriminim¹⁹.

Sa më sipër rezulton se fëmijës së ankuesit nuk i është garantuar arsim gjithpërfshirës cilësor pasi atij nuk i është garantuar mbështetja me mësues ndihmës sipas edhe parashikimeve ligjore në fuqi.

Shkelja e të drejtës për arsim mund të ndodhë si nëpërmjet veprimeve ashtu edhe nëpërmjet mosveprimit duke mos marrë ato masa që autoritetet përgjegjëse janë të detyruara të ndërmarin për të siguruar të drejtën për arsim. Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, garantohet për çdo veprim ose mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë. Pikat 1 dhe 2, të nenit 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktojnë se diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, personi me aftësi të kufizuara trajtohet në mënyrë më pak të favorshme se personat e tjerë që nuk e kanë aftësinë e kufizuar. Motivi apo qëllimi për të diskriminuar nuk ka rëndësi në arritjen e konkluzionit nëse diskriminimi ka ndodhur apo jo, pasi në mungesë të qëllimit ekzistenca e pasojave tregon se diskriminimi ka ndodhur.

Vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin parashkollor nga komisioni multidisiplinar është përgjegjësi e ZVA Tiranë (ish DAR Tiranë). Sa më sipër rezultoi e provuar se ZVA Tiranë (ish DAR Tiranë) nuk ka vepruar në përputhje me afatet kohore të përcaktuara nga dispozitat ligjore në fuqi pasi nuk ka bërë vlerësimin e fëmijës përpara fillimit të vitit shkollor 2018-2019 si dhe vitit shkollor 2019-2020.

¹⁸ Shiko Komentin e Përgjithshëm Nr.13 (1999), të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi të drejtën për arsim.

¹⁹ Shiko Komentin e Përgjithshëm nr. 6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

DPÇK, Bashkia Tiranë (ish QEZHEF) duke mos vepruar nuk ka zbatuar rekomandimet e komisionit multidisiplinar të ngritur pranë institucionit arsimor vendor (DAR Tiranë gjatë vitit shkollor 2018-2019 dhe ZVA Tiranë gjatë vitit shkollor 2019-2020) për të siguruar mësuesin ndihmës për fëmijën O.K.

Pretendimi i DPÇK, Bashkia Tiranë, se nuk është kompetencë e saj caktimi i mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët frekuentojnë institucionet e arsimit parashkollor në qytetin e Tiranës është i pabazuar. Në bazë të nenit 23, pika 12, të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, përcaktohet se administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe të cilat ndodhen në territorin e juridiksionit të tyre është përgjegjësi e bashkive. Në rastin konkret fëmija O.K frekuenton institucionin arsimor publik të arsimit parashkollor Kopshtin nr.18, në qytetin e Tiranës. Për rrjedhojë bazuar në këtë dispozitë ligjore caktimi i mësuesit ndihmës për fëmijën i cili ndjek një nga institucionet e arsimit parashkollor në qytetin e Tiranës është përgjegjësi e Bashkisë Tiranë.

DPÇK, Bashkia Tiranë është institucion vendor, person juridik publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës, e cila është njësi e vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilës ndodhet institucioni arsimor parauniversitar Kopshti nr. 18, i cili frekuentohet nga fëmija O.K. Për këtë arsye DPÇK, si një institucion në varësi të Bashkisë Tiranë është përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopsht, sipas nenit 23/12 të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*. Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopsht është një nga funksionet e reja që u është transferuar bashkive sipas ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*.

Në fillim të dy viteve shkollore atij 2018-2019²⁰ dhe 2019-2020²¹, në udhëzimet e përbashkëta respektive të miratuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (për arsimin profesional) në pjesën ku trajtohet arsimi parashkollor përcaktohen detyrat me përparësi që duhet të ndiqen nga institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar (DRAP dhe ZVAP), drejtuesit e kopshteve publike, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, por pa specifikuar se cila detyrë duhet të përmbushet nga secili prej institucioneve të cituara. Realizimi i këtyre detyrave është e kuptueshme që duhet të bëhet nga këto institucione bazuar në funksionet dhe kompetencat ligjore që u janë ngarkuar nga legjislacioni në fuqi. Në mënyrë të qartë ligji *“Për vetëqeverisjen vendore”* ka përcaktuar se administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopsht është përgjegjësi e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për këtë arsye përcaktimi i bërë në Kreun I, pjesa I.1, pika 5 e udhëzimit të përbashkët nr. 18 datë 20.08.2019 të MASR dhe MFE, për fillimin e vitit shkollor 2019-2020 në sistemin arsimor parauniversitar, për ndjekjen me përparësi të caktimit të mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ato kopshte ku ka fëmijë sipas rekomandimit të dhënë nga komisioni multidisiplinar në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, bazuar në portalin

²⁰ Udhëzimi i përbashkët nr. 27 datë 16.08.2018 i MARS dhe MFE.

²¹ Udhëzimi i përbashkët nr. 18 datë 20.08.2019 i MARS dhe MFE.

“Mësues për Shqipërinë”, është detyrë që duhet të realizohet me përparësi nga Bashkia Tiranë, në cilësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjegjëse për Kopshtin nr.18, në Tiranë.

Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopësht dhe çerdhe në Bashkinë e Tiranës realizohet nga DPÇK, si një institucion varësie e kësaj bashkie. Pas miratimit të ligjit “*Për vetëqeverisjen vendore*” personeli arsimor dhe ai ndihmës është në varësi të DPÇK, Bashkia Tiranë (ish QEZHF). I njëti përcaktim i bërë si më sipër në udhëzimin e përbashkët për fillimin e vitit shkollor 2019-2020, ka qënë i parashikuar edhe në Kreun III, pjesa I, pika 2, gërma “e” në udhëzimin e përbashkët të MARS dhe MFE nr. 27 datë 16.08.2018, për vitin shkollor 2018-2019 në sistemin arsimor parauniversitar.

Në korrespondencën që është mbajtur gjatë vitit shkollor 2018-2019 midis DAR Tiranë (sot ZVA Tiranë), QEZHEF (sot DPÇK) dhe ankuesit, rezulton se QEZHEF ishte përgjegjëse për caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara që frekuentojnë kopshtet publike në territorin e Bashkisë Tiranë. Me shkresën nr. 66/1 datë 28.01.2019 drejtuar prindërve të fëmijës, QEZHEF është shprehur se sapo të disponojë informacionin nga komisioni multidisiplinar i ngritur pranë DAR Tiranë për vitin shkollor 2018-2019, do të përlllogarisë sipas nevojave numrin e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara në kopshtet. QEZHEF ka marrë informacionin në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara në kopësht të cilët duhet të asistohen me mësues ndihmës me shkresën nr.1154 prot datë 06.03.2019 të DAR Tiranë, por nuk rezulton të këtë marrë asnjë veprim për të përlllogaritur nevojat për mësues ndihmës për fëmijët. Edhe për sa i takon vitit aktual shkollor 2019-2020, DPÇK, Bashkia Tiranë nuk ka marrë asnjë masë në drejtim të përlllogaritjes së nevojave dhe sigurimit të mësuesve ndihmës për fëmijët të cilët janë vlerësuar nga komisioni multidisiplinar i ngritur pranë ZVA Tiranë, informacion i cili i është dërguar nga kjo e fundit me datë 07.01.2020 me shkresën 63/1 prot.

Asistimi me mësues ndihmës vetëm një ditë në javë, çdo ditë të premte, është në kundërshtim me vlerësimin e komisionit multidisiplinar sipas të cilit fëmija duhet të asistohet 5 orë mësimore në javë e shtrirë kjo ndihmë 1 orë mësimore për çdo ditë. Një situatë e tillë vjen në kundërshtim me pikën 6, të Kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 26, datë 25.11.2019 “*Për mësuesin ndihmës me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar*”. Në këtë pikë përcaktohet qartë se është komisioni multidisiplinar i ngritur pranë ZVAP-ve që bën vlerësimin e nevojave të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe përcakton ndër të tjera numrin e orëve. Komisioni multidisiplinar ka përcaktuar se fëmija O.K duhet të asistohet 5 orë mësimore në javë dhe se kjo asistencë duhet t’i ofrohet fëmijës çdo ditë me 1 orë mësimore.

Në shkresën nr. 1787 prot datë 04.03.2020, ZVA Tiranë shprehet se, bazuar në pikën 7, të Kreut I, të Udhëzimit nr.26, datë 25.11.2019, shpërndarja e orëve mësimore bëhet nga drejtori i institucionit arsimor në bashkëpunim me komisionin multidisiplinar pranë institucionit arsimor, në përputhje me rekomandimet e komisionit multidisiplinar. Në lidhje me këtë qëndrim Komisioneri vlerëson se: *së pari*, pika 7, e udhëzimit nuk ka të bëjë me orët mësimore me të cilat duhet të asistohet fëmija me aftësi të kufizuara, pasi ato përcaktohen nga komisioni multidisiplinar, por me orët mësimore dhe ngarkesën e mësuesit ndihmës dhe *së dyti*, asnjë autoritet tjetër, si drejtuesi i

institucionit arsimor apo komisioni multidisiplinar pranë institucionit arsimor nuk mund të veprojë në kundërshtim me vlerësimin dhe rekomandimin e komisionit multidisiplinar pranë ZVAP-ve. Është në kundërshtim me rekomandimin e komisionit multidisiplinar ofrimi i asistencës me mësues ndihmës vetëm një ditë në javë, qoftë edhe nëse gjatë kësaj dite zhvillohen të 5 orët mësimore të rekomanduara nga ky komision. Kjo asistencë e ofruar në këtë mënyrë cënon efektivitetin e mbështetjes së ofruar.

Legjislacioni në fuqi në këtë drejtim nuk është diskriminues dhe ofron asistencën me mësues ndihmës, por autoritetet përgjegjëse kanë dështuar për të marrë masat për të adresuar diskriminimin *de-fakto* i cili në rastin konkret ka ardhur nga moszbatimi i duhur i tyre. Kjo përbën shkelje dhe cënim të të drejtës për të mos u diskriminuar.

Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioneri vlerëson se fëmija O.K, është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme në raport me fëmijët e tjerë pa aftësi të kufizuara, pasi duke mos i'u siguruar mbështetja me mësues ndihmës atij nuk i është siguruar një arsim gjithpërfshirës cilësor dhe në baza të barabarta. Ky trajtim i pafavorshëm është i lidhur pikërisht me faktin që fëmija O.K është një fëmijë me aftësi të kufizuara. Thënë kjo, nuk nënkupton që ka qenë qëllim i autoriteteve përgjegjëse për të bërë një trajtim të tillë, por se ata kanë dështuar për hequr pengesat dhe për të ofruar mbështetjen e parashikuar nga ligji. Vendosja në kushte më pak të favorshme ka si bazë aftësinë e kufizuar, pasi në mungesë të saj O.K nuk do të kishte nevojë për mbështetje. Komisioneri vlerëson se kjo vjen në kundërshtim me nenin 3/1/2, 7/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe se fëmija O.K, është diskriminuar në të drejtën e tij për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Diskriminimi i fëmijës O.K është konsumuar njëkohësisht si nëpërmjet mosveprimit në kohë nga ana e ZVA Tiranë ashtu edhe mosveprimit nga ana e DPÇK, Bashkia Tiranë, sjellje të cilat kanë gjeneruar një situatë në të cilën fëmijës O.K i është kufizuar e drejta për të marrë një arsim gjithpërfshirës cilësor dhe në baza të barabarta me fëmijët e tjerë. Për këtë arsye DPÇK, Bashkia Tiranë dhe ZVA Tiranë janë bashkarisht përgjegjëse për situatën diskriminuese në të cilën është vendosur fëmija O.K.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në të drejtën për arsim të fëmijës O.K, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë dhe Zyrës Vendore Arsimore Tiranë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, të marri masa të menjëhershme për të asistuar me mësues ndihmës fëmijën O.K, me 5 orë mësimore në javë, duke e shpërndarë këtë ngarkesë mësimore me 1 orë mësimore në ditë, në përputhje me rekomandimin e komisionit multidisiplinar.

3. Rekomandohet Bashkia Tiranë, të marrë masa për informimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë kopshtet publike publik në territorin e kësaj bashkie, mbi të drejtën e fëmijëve për t'u asistuar me mësues ndihmës.
4. Zyra Vendore Arsimore Tiranë të mos ndërpresë asistencën me mësues ndihmës që ofron aktualisht për fëmijën O.K deri në ofrimin e saj nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë dhe njëkohësisht të marrë masa që asistenca me mësues ndihmës të ofrohet në përputhje me rekomandimin e komisionit multidisiplinar, duke e shpërndarë ngarkesën mësimore që aktualisht ofrohet nga mësuesi ndihmës ditën e premte me 1 orë mësimore çdo ditë.
5. Zyra Vendore Arsimore Tiranë, të marri masa për mbledhjen e komisionit multidisiplinar tri herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të periudhës së parë dhe në fund të vitit mësimor, në respektim të nenit 80, pika 4, të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë dhe Zyra Vendore Arsimore Tiranë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
7. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Arsim

Shkaku i diskriminimit: Aftësia e kufizuar